



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac / Municipality of Rahovec

RAHOVEC / ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 127 Nr. i faq./Br.str./No.pg 1/123

Data/Datum/Date 30 / 08 / 2023

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 pika (d), nenit 17 dhe nenit 40 paragrafi 2 pika (d) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 4 paragrafi 1 pika 1.5 lidhur me nenin 14, paragrafi 1, pika 1.7 i Rregullores (MAPL) Nr. 02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës, Strategjisë për përfshirjen e Komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare 2022 – 2026, nenit 10, paragrafi 2, pika 2.4, nenit 40, paragrafi 2, pika 2.4 dhe nenit 57 të Statutit të Komunës Rahovec, Nr.1005, i datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 30.08.2023, miraton këtë:

V E N D I M

Për miratimin e Planit të veprimit për përfshirjen e komunitetit rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare – Komuna Rahovec 2023-2025

1. Me këtë vendim, miratohet Plani i veprimit për përfshirjen e komunitetit rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare – Komuna Rahovec 2023-2025.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani i veprimit për përfshirjen e komunitetit rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare – Komuna Rahovec 2023-2025.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset kryetari i Komunës dhe Zyra Komunale për Kthim dhe Komunitete në Komunën Rahovec.
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës Rahovec, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- Shërbimit të Kuvendit,
- Kryetarit të Komunës,
- MAPL-së, dhe
- Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.127/23
Datë:30.08.2023

